ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Autoritetin Kontraktues – Ndërmarrja Publike Banesore**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **1909466981031194-24-3857-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **"Furnizim me elemente të parafabrikuara nga betoni"**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"Flamuri V" SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. "Rilindja Kombëtare" pn.
(Adresa)

Malishevë — **24000**
(Vendi) — *(Kodi postar)*

+383 (0)49 24 44 87
(Numri Telefonit)

Vllaznim Mazreku, Drejtor Menaxhues
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

flamurivshpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

01.07.2024
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ — _____
(Numri i Telefonit) — *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ — _____
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

"Furnizim me elemente të parafabrikuara nga betoni" *Njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit – 19.04.2024* *Njoftimi mbi vendimin – 12.06.2024* *Kërkesa për rishqyrtim – 18.06.2024* *Vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim – 21.06.2024*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se. **Kërkesa për rishqyrtim – 18.06.2024** **Vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim – 21.06.2024**

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 59 par. 4 i LPP lidhur me nenin 40 të RRPP

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

SH.P.K FLAMURI V 2 Malishevë

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues përmes njoftimit mbi vendimin ka rekomanduar për kontratë një operator ekonomik të papërgjegjshëm pasi që nuk ka përmbushur kërkesat e FDT.

Pretendimi i parë - Në dosjen e tenderit është formuluar kërkesa si në vijim: "*Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka realizuar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme (së paku një kontratë për furnizime me materiale të ngjashme) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Shuma totale e kontratave të realizuara të jetë në vlerë jo më pak se 150,000.00 € (njëqind e pesëdhjetë mijë) euro*". Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Një listë e kontratave të natyrës së njejtë apo të ngjashme (e nënshkruar dhe e vulosur) të realizuara në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar furnizimet e kryera, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur punimet janë kryer për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi shërbejnë (referenca pozitive ose raporti i pranimit teknik) të lëshuar ose të bashkë-nënshkruar nga autoriteti i tillë"*. Tenderuesi i rekomanduar nuk ka përmbushur kërkesën e DT të cituar si më sipër, për arsyet e elaboruara si në vijim.

Tenderuesi i rekomanduar për kontratë NNT BINI SHPK ka dorëzuar dy lista të kontratave me përmbajtje të ndryshme. Për ilustrim, shih figurat vijuese:

FIG. 1 – LISTA E PARË

N.N.T. BINI

LISTA E KONTRATAVE TË KOMPANISË NNT BINI SHPK

Aneksi 6. Lista e kontratave te realizuara ne 3 vitet e fundit
(Ky Aneks është obligativ qe te plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton performimin e tillë)

NR.	TITULLI I KONTRATËS	DATA E NËNSHKRIMIT	DATA E PËRFUNDIMIT TË KONTRATËS	VLERA E KONTRATES	EMRI I BLERËSIT	EMAILI I BLERËSIT	NUMRI I PROKURIMIT
1	Zgjerimi I shtratit të lumit Llap dhe Dumnica me mure mbrojtse (Gab	24.11.2023		149 612,20 €	Komuna e Podujevës	prokurimi.podujeva@rks-gov.net	615-23-9428-5-2-1
2	Ndërtimi i rrugeve me elemete beloni(ndertimi i rrugeve me kubeza betoni ndertimi i kalesave te vogla ne trotuare ,ndertimi i urave te vogla per këmbsor) në qytet dhe fshatra	20.9.2023		458 371,05 €	Komuna e Podujevës	prokurimi.podujeva@rks-gov.net	615-23-7616-5-2-1
3	Ndërtimi i trotuareve në qytet	30.8.2023		349 896,10 €	Komuna e Podujevës	prokurimi.podujeva@rks-gov.net	615-23-6653-5-2-1
4	Ndërtimi I rrjetit te kanalizimeve fekale dhe atmosferike llot II	2.8.2023	28.3.2024	222 250,00 €	Komuna e Podujevës	prokurimi.podujeva@rks-gov.net	615-23-4020-5-1-1
5	Mirëmbajtja e insfrastruktures publike (kanalizim dekal dhe atmosferik)	11.7.2023		50 000,00 €	Komuna e Podujevës	prokurimi.podujeva@rks-gov.net	615-23-5436-2-2-1
6	Zgjerimi dhe rregullimi i shtratit te lumenjeve	5.5.2023		804 870,97 €	Komuna e Podujevës	prokurimi.podujeva@rks-gov.net	615-23-1637-5-1-1
7	Ngritja e infrastruktures se turizmit	27.4.2002		248 876,34 €	Komuna e Podujevës	prokurimi.podujeva@rks-gov.net	615-23-1023-5-2-1
8	Ndërtimi i trotuareve në qytet dhe fshatra	5.4.2023	3.10.2023	188 681,52 €	Komuna e Podujevës	prokurimi.podujeva@rks-gov.net	615-22-8997-5-2-1
9	Mirëmbajtja e insfrastruktures publike (kanalizim dekal dhe atmosferik)	10.3.2023		60 000,00 €	Komuna e Podujevës	prokurimi.podujeva@rks-gov.net	615-23-87-2-2-1
10	Largimi I deponive ilegale	7.3.2023	3.4.2023	19 108,92 €	Komuna e Podujevës	prokurimi.podujeva@rks-gov.net	615-23-178-2-2-1
11	Intervenimet per rastet emergjente - vershimet	13.2.2023	28.2.2023	131 759,39 €	Komuna e Podujevës	prokurimi.podujeva@rks-gov.net	615-23-492-2-1-5

FIG. 2 – LISTA E DYTË

S.H.P.K FLAMURI V 2 Malishevë

N.N.T. BINI

LISTA E KONTRATAVE TË KOMPANISË NNT BINI SHPK

Aneksi 6. Lista e kontratave te realizuara ne 3 vitet e fundit
(Ky Aneks është obligativ qe te plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton performimin e tillë)

NR.	TITULLI I KONTRATËS	DATA E NËNSHKRIMIT	DATA E PËRFUNDIMIT TË KONTRATËS	VLERA E KONTRATES	EMRI I BLERËSIT	EMAILI I BLERËSIT	NUMRI I PROKURIMIT
1	Furnizim me elemete te parafabrikuara nga betoni	8.4.2021	11.4.2022	36 900,00 €	Komuna e Podujevës	prokurimi.podujeva@rks-gov.net	615-23-9428-5-2-
2	Ndërtimi i rrugeve me elemete betoni(ndertimi i rrugeve me kubeza betoni ndertimi i kafesave te vogla ne trotuare ,ndertimi i urave te vogla per këmbsor) në qytet dhe fshatra	20.9.2023	7.5.2024	458 371,05 €	Komuna e Podujevës	prokurimi.podujeva@rks-gov.net	615-23-7616-5-2-
3	Ndërtimi i trotuareve në qytet	30.8.2023		349 896,10 €	Komuna e Podujevës	prokurimi.podujeva@rks-gov.net	615-23-6653-5-2-
4	Ndërtimi I rjetit te kanalizimeve fekale dhe atmosferike llot II	2.8.2023	28.3.2024	222 250,00 €	Komuna e Podujevës	prokurimi.podujeva@rks-gov.net	615-23-4020-5-1-
5	Mirëmbajtja e Insfrastruktures publike (kanalizim dekal dhe atmosferik)	11.7.2023		50 000,00 €	Komuna e Podujevës	prokurimi.podujeva@rks-gov.net	615-23-5436-2-2-
6	Zgjerimi dhe rregullimi i shtratit te lumenjeve	5.5.2023		804 870,97 €	Komuna e Podujevës	prokurimi.podujeva@rks-gov.net	615-23-1637-5-1-
7	Ngritja e infrastruktures se turizmit	27.4.2002	18.12.2023	248 876,34 €	Komuna e Podujevës	prokurimi.podujeva@rks-gov.net	615-23-1023-5-2-
8	Ndërtimi i trotuareve në qytet dhe fshatra	5.4.2023	3.10.2023	188 681,52 €	Komuna e Podujevës	prokurimi.podujeva@rks-gov.net	615-22-8997-5-2-

Në dosjen e tenderit është kërkuar që operatori ekonomik të ofroj dëshmi se ka realizuar kontrata të natyrës së ngjashme me natyrën e tenderit ku së paku një nga këto kontrata duhet të jetë për furnizim me elemente të parafabrikuara nga betoni. Në listën e parë, tenderuesi i rekomanduar nuk ka prezantuar asnjë kontratë për furnizim me elemente të parafabrikuara nga betoni. Ndërsa në listën e dytë ka prezantuar një kontratë me titull "furnizim me elemente të parafabrikuara nga betoni" me autoritetin kontraktues Komuna e Podujevës me nr. të prokurimit 615-23-9428-5-2-1. Kësaj liste (pra listës së dytë) tenderuesi i rekomanduar i ka bashkangjitur një kontratë me titull tjetër përkatësisht "furnizim me elemente të parafabrikuara nga betoni lot 1", pastaj me një tjetër AK respektivisht me NPB si dhe me tjetër nr. 1909466981031194-21-839-1-2-1/C79. Pra tjetër kontratë ka prezantuar në listën e dytë dhe tjetër kontratë i ka bashkangjitur kësaj liste (të cilat dallojnë për nga titulli, autoriteti kontraktues dhe numri i kontratës). Mbi të gjitha, tenderuesi i rekomanduar nuk ka prezantuar fare referencë ose raport të pranimit teknik lidhur me këtë kontratë. Duhet theksuar se në dosjen e tenderit është kërkuar shprehimisht që listës t'i bashkangjiten edhe referencat dhe/apo raportet e pranimit teknik. Pra nuk është kërkuar që të bashkangjitet kontrata por vetëm referenca. Duke marrë parasysh faktin se në listë është përfshkruar kontratë tjetër ndërsa është bashkangjitur kontratë tjetër si dhe nuk është bashkangjitur fare referenca as për njërën as për tjetrën kontratë, rezulton se tenderuesi kontraktues nuk e ka përmbushur këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Vlen të shtohet se tenderuesi i rekomanduar ka bashkangjitur me listën e parë disa kontrata dhe raporte të pranimit teknik mirëpo të cilat nuk janë të natyrës së ngjashme me natyrën e tenderit "Furnizim me elemente të parafabrikuara nga betoni".Rrjedhimisht tenderuesi i rekomanduar "NNT BINI SHPK" është dashur që të eliminohet si tenderues i papërgjegjshëm dhe jo të rekomandohet për dhënie të kontratës. Këtij fakti duhet shtuar po ashtu se në dosjen e tenderit është kërkuar vetëm një listë e kontratave dhe jo dy të tilla. Duke qenë se janë dorëzuar dy lista të tilla, autoriteti duhet të shpjegoj se cilës prej këtyre listave autoriteti i ka falur besimin dhe për cilën arsye i ka falur besimin pikërisht njërës ose tjetrës listë. E vërteta është se asnjëra prej listave as nuk është plotësuar sipas udhëzimeve në Fletën e të Dhënave të Tenderit. Si shembull mund të merret vetëm fakti se datat e përfundimit pa çka se kërkesa e DT ka qenë shprehimisht që të listohen kontratat e përfunduara në 3 vitet e fundit para njoftimit për kontratë "*duke saktësuar furnizimet e kryera, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit*". Ndërsa në listën e parë mungon data e përfundimit për kontratën nr. 1, 2, 3, 5, 6, 7, 9, 14, ndërsa në listën e dytë mungon data e përfundimit për kontratën nr. 5, 6, 9, 14, etj. Pra nga cilido këndvështrim i mundshëm, tenderuesi i rekomanduar "NNT BINI SHPK" ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme sepse nuk e ka përmbushur këtë kërkesë të DT.

Pretendimi i dytë – kërkesa e dosjes së tenderit është formuluar si vijon "*Raportin e vlerësimit të Riskut për vendin e punës (kopje e noterizuar)*". Tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar raportin e vlerësimit të riskut të noterizuar nga personi i paautorizuar. Drejtor menaxhues dhe përfaqësues i autorizuar i OE "NNT BINI SHPK" është z. Afrim Hajdari.

FLAMURI V 2 Malishevë

Ndërsa raporti i vlerësimit të riskut është dorëzuar për noterizim nga z. Avdi Vuça i cili nuk është as drejtor menaxhues dhe as përfaqësuar i autorizuar nga drejtori menaxhues dhe as përfaqësues sipas ligjit dhe/apo statutit. Prandaj nuk është person i autorizuar për të dorëzuar për noterizim këtë dokument. Rrjedhimisht raporti i vlerësimit të riskut – kopja e noterizuar të cilën e ka dorëzuar me ofertë tenderuesi i rekomanduar nuk duhet të merret parasysh nga komisioni vlerësues sepse si i tillë nuk është në përputhje me kërkesat e DT. Me fjalë të tjera OE "NNT BINI SHPK" ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme edhe në këtë pikë prandaj është dashur që të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit dhe jo të rekomandohet për dhënie të kontratës.

Fig. 3. Vërtetimi noterial

Republika e Kosovës
NOTER
SINAN VISOKA

LRP. Nr.6200/2024

Sot me datën 10.05.2024 (Dhjete Maj Dymijëenjëzete Kater), unë Noter Sinan Visoka , zyra në Podujevë Rr. Dr. Bajram Krasniqi p.nr., konform nenit 43 par.1 të LNK-ës. ----------

Vërtetoj se, dokumenti i quajtur **RAPORTI FINAL** , datës **12.06.2023** të cilin e ka sjellë **AVDI VUÇA** i lindur me datë 12.08.1987 në Shtedim ,shtetase e Kosovës , indentifikimin e të cilit e bëra përmes letërnjoftimit me numër personal 1173580025 të leshuar nga MPB e Republikës së Kosovës , përbëhet prej një kopje dhe 4 faqe, është në çdo aspekt identike, **konform Origjinalit** dhe pas krahasimit është noterizuar.- Dokumentin e përcaktuar nga pala si origjinal, e ka sjellë vetë ai dhe të njëjtin e tërhjek me kopjen e vërtetuar.----------
Sipas deklaratës së palës origjinali i dokumentit është në duart e tij. ----------
Bazuar në Ligjin mbi Noterinë, Noteri nuk përgjigjet për përmbajtjen e këtij dokumenti.----------
Shpenzimet noteriale në shumë prej 1 € (Një) plus TVSH 18% 1.18€ për çdo faqe janë paguar në bazë të nenit 27 të Udhëzimit Administrativ Nr.05/2022 për tarifat noteriale.----------
- Veprimi i noterizimit u ndërmorr me datë 10.05.2024 (Dhjete Maj Dymijëenjëzete Kater).----------

N O T E R I: SINAN VISOKA

Pretendimi i tretë – në dosjen e tenderit është formuluar kërkesa si në vijim "*Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka të angazhuar personel/staf të mjaftueshëm profesional e teknik. Minimum 8 punëtorë të cilët duhet të jenë të çertifikuar nga MMPS apo ndonjë organizatë e licencuar, për Siguri dhe Shëndet në punë si dhe pësr Mbrojtje nga Zjarri*". Pra sipas dosjes së tenderit janë kërkuar 8 punëtorë të çertifikuar për mbrojtje nga zjarri. Në anën tjetër tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar vetëm 6 çertifikata për mbrojtje nga zjarri për vetëm 6 punonjës të cilët janë në listën e punonjësve që ka dorëzuar tenderuesi i rekomanduar. Tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar edhe 2 çertifikata për mbrojtje nga zjarri për 2 persona të tjerë (Arben Mazreku dhe Rizah Muqolli) mirëpo të cilët nuk evidentohen fare si punonjës në listën e punonjësve të kompanisë. Rrjedhimisht tenderuesi i rekomanduar nuk e ka përmbushur as këtë kërkesë të dosjes së tenderit për për këtë arsye është dashur të eliminohet si tenderues i papërgjegjshëm edhe në këtë pikë.

Pretendimi i katërt – në dosjen e tenderit është formuluar kërkesa si në vijim "*Një listë e personelit/stafit profesional dhe teknik (e nënshkruar dhe e vulosur), bashkë me dokumentet përcjellse si: kontratat valide të punës për secilin prej tyre (origjinale të nënshkruara dhe vulosura nga punëdhënësi dhe punëmarrësi, ose kopje të noterizuara të dorëzohen të skanuara); çertifikatat për siguri dhe shëndet në punë për secilin prej tyre (origjinal ose kopje të noterizuara); dhe çertifikatat për mbrojtje nga zjarri për secilin prej tyre, (origjinal ose kopje të noterizuara)*".

Tenderuesi i rekomanduar "NNT BINI SHPK" ka dorëzuar listën e stafit mirëpo kësaj liste nuk i ka bashkangjitur dokumentet e nevojshme sikurse është përcaktuar me dosjen e

FLAMURI V 2 Malishevë

tenderit. Pra në dosjen e tenderit është kërkuar që OE të dorëzoj listën e punëtorëve dhe për secilin punonjës të bashkangjitë kontratat e punës. Nga ky këndvështrim, duhet cekur se tenderuesi i rekomanduar ka evidentuar gjithsej 36 punonjës, mirëpo vetëm për 31 prej tyre ka dorëzuar edhe kontratat e punës. Konkretisht mungojnë kontratat e punës për punonjësit e evidentuar në listën e punonjësve me nr. 8 Elena Besholli, 27 Delfina Hajdari, 28 Aziz Hasani, 29 Dea Qoqaj dhe 30 Ismet Xhemajli. Rrjedhimisht tenderuesi i rekomanduar nuk ka arritur që të dorëzoj të gjitha dëshmitë e nevojshme dokumentare sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Në këtë drejtim duhet shtuar se për punonjësen me nr. 8 Elena Besholli është dorëzuar edhe çertifikata për mbrojtje nga zjarri mirëpo përderisa për këtë punonjësve nuk është bashkangjitur kontrata e punës sikurse është kërkuar me DT, të njëjtës nuk duhet t'i merret parasysh as çertifikata për mbrojtje nga zjarri. Pra nga të gjitha këndvështrimet e mundshme, tenderuesi i rekomanduar është i papërgjegjshëm dhe në këtë pikë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Do të precizohen.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

SH.P.K FLAMURI V Malishevë